



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

PN.nr.251/22

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, gjyqtarja e procedurës paraprake Edita Çanta, në çështjen e procedurës paraprake kundër të dyshuarit Ylber Hyseni për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rremë nga neni 391 par.1 dhe veprës penale: Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës së prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.NR.4829/22 të datës 26.05.2023, të plotësuar nga prokuroria me datë 22.03.2024, sipas rekomandimeve të Kolegjit të Gjykatës së Apelit, me numër reference: PN.nr.1058/2023 të datës 18.12.2023, për lëshimin e Urdhërit Ndalues Përfundimtar të pronës së paluajtshme, konform nenit 264, par.2 dhe nenit 268 të Kodit të Procedurës Penale, me datë 15.05.2024, lëshon këtë :

#### AKTVENDIM

**I.REFUZOHET** kërkesa për Urdhër Ndalues Përfundimtar e pronës së paluajtshme, me datë 24.05.2023, e plotësuar dhe përmirësuar me datë 22.03.2024 ndaj të dyshuarit Ylber Hyseni për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rremë nga neni 391 par.1 dhe veprës penale: Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së me të cilën prokuroria ka kërkuar ndalimin/sekuestrimin e përkohshëm të parcelës kadastrale:

- **Parcela kadastrale nr. 1743-0 , Zona Kadastrale-Prishtinë, me sipërfaqe prej 2.88.29 ha, në vendin e quajtur “Veternik” e cila ka pësuar ndryshimet si më poshtë:**
  1. Ngastra kadastrale 1743-3 me pronar [REDACTED] me certifikatë P-71914059-1743-1, me sipërfaqe prej 2500 m<sup>2</sup>;
  2. Ngastra kadastrale 1743-3 me pronar Ylber Hyseni me certifikatë P-71914059-1743-2, me sipërfaqe prej 2500 m<sup>2</sup>; parcelizohet në 1743-16 në sipërfaqe në 1500 dhe 1743-17, në sipërfaqe në 1000;
  3. Ngastra kadastrale 1743-3 me pronare [REDACTED] me certifikatë P-71914059-1743-3, me sipërfaqe prej 2500 m<sup>2</sup> parcelizohet në (1743-41 dhe 1743-42);

4. Ngastra kadastrale 1743-4)me pronar [REDACTED] me certificate P-719140591743-4 me sipërfaqe prej 900 m2 parcelizohet në (1743-35, 1743-36 dhe 1743-37;
5. Ngastra kadastrale 1743-5 me pronar [REDACTED] me çerfikatë P-71914059-1743-5, me siperfaqe prek 1600 m2 parcelizohet në (1743-38, 1743-39 dhe 1743-40);
6. Ngastra kadastrale 1743-5 me pronar [REDACTED] me çertifikatën P-71914059-1743-5 me sipërfaqe prej 500 m2 e blerë nga [REDACTED];
7. Ngastra kadastrale 1743-6 me pronar [REDACTED] me certificate P-71914059-me siperfaqe prej 600 m2 parcelizohet në (1743-32, 1743-33 dhe 1743-34);
8. Ngastra kadastrale 1743-7me pronar [REDACTED] me çertifikatë P-71914059-1743-7, me sipërfaqe prej 1021m2 parcelizohet në (1743-29, 1743-30 dhe 1743-41);
9. Ngastra kadastrale 1743-8 me pronar [REDACTED], me çertifikatë P-71914059- 1743-8, me sipërfaqe prej 1752 m2;
10. Ngastra kadastrale 1743-8 me bashkëpronar [REDACTED] me sipërfaqe prej 902 m2 dhe [REDACTED] me sipërfaqë 850 m2 me çertifikatë P-7191459-1743-8, parcelizohet në: 1743-26, 1743-27 dhe 1743-28;
11. Ngastra kadastrale 1743-9 me pronar Ylber Hyseni me çertifikatë P-71914059-1743-9 me sipërfaqe prej 1519 m2 parcelizohet në:1743-18,1743-19.
12. Ngastra kadastrale 1743-11 me pronare [REDACTED] me çertifikatë P-71914059-1743-11me sipërfaqe prej 2500 m2.
13. Ngastra kadastrale 1743-16 me pronar Ylber Hyseni me çertifikatë P-71914059-1743-16, me sipërfaqe prej 1500 m2 parcelizohet në: 1743-24, 1743-46, 1743-47;
14. Ngastra kadastrale 1743-17me pronare [REDACTED] me certifikatë P-71914059-1743-17m, me siperfaqe prej 1000 m2 parcelizohet ne( 1743-43, 1743-44 dhe 1743-45);
15. Ngastra kadastrale 1743-19 me pronar [REDACTED] me çertifikatë P-71914059-1743-19, me sipërfaqe prej 595 m2 parcelizohet në:1743-48, 1743-49;
16. Ngastra kadastrale 1743-21 me pronar [REDACTED] me çerfikatë P-71914059-1743-10, me sipërfaqe prej 280 m2



II. Me këtë aktvendim njoftohen të gjitha palët në procedurë, si dhe personat që kanë interes juridik në pasurinë e specifikuar në kërkesën me numër PP/II.nr.4829/22 të datës 26.05.2023 të përmirësuar me datë 22.03.2024 nga prokuroria e shtetit.

### Arsyetimi

Me datë 24.05.2023 Prokuroria Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm ka paraqitur kërkesën për lëshimin e urdhërit përfundimtar, me numër PP//II.Nr.4829/2022, të datës 24.05.2023, kundër të dyshuarit: Ylber Hyseni, për shkak të dyshimit të bazuar të kryerjes së veprës penale: Legalizimi i përmbajtjes së rremen nga neni 393 par.4 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me par.1 dhe par.77 të KPRK-së. E njëjta në kërkesën e përmirësuar ka paraqitur parcelën kadastrale me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të bëhet ndalimi/sekuestrimi i përkohshëm i/dhe parcelës kadastrale nr.1743-0, Zona Kadastrale, Prishtinë me sipërfaqe 2.88.29 ha e cila ka pësuar ndryshimet që i ka përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktvendimi duke i renditur të gjitha ngastrat kadastrale dhe pronarët e tyre. Tutje, në kërkesë prokuroria ka deklaruar se në kërkesën e bërë në mënyrë të organizuar, është kërkuar bashkimi i të gjitha ngastrale kadastrale të lartcekura në një parcelë e cila tanime evidentohet si ngastra kadastrale 10433-0 dhe për cilën ekziston vendimi i datës 26.07.2022 për lejen ndërtimore për ndërtimin e kompleksit "Prishtina e Re", me ndërtesa të shumë banesore&afariste dhe të gjitha këto ngastra janë blerë nga tani pronarët e rinj nga ish pronari tani i pandehuri Ylber Hyseni dhe aseteve të vendosura në të.

Konkretisht për paluajtshmërinë nr.10433-0, e evidentuar në emër të [REDAKTUAR] me numër të biznesit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe pronarëve, bashkëpronarëve, bashkëinvestuesve, bashkimit të pronave dhe kapitalit: [REDAKTUAR]

Përmes kësaj kërkesë, prokuroria ka kërkuar të ndalohet shitja, blerja, lising, qira, parablerje, investim i përbashkër, dhe forma të tjera të lokaleve, banesave suterenem garazhe, bodrume, pent hauese dhe njësisive tjera investive në çdo pjesë të ndërtuar të pronës e cila shtrihet si pjesë e ngastrës kadastrale nr.10433-0.

Prokuroria me anë të kërkesës, ka kërkuar që gjykata të urdhërojë komunën e Prishtinës, Drejtorinë e Kadastrit që të mos bëjë bartje/regjistrim apo tjetërsime që kanë të bëjnë me ngastrën kadastrale nr.10433-0.

Ka kërkuar t'iu ndalohet të pandehurit Ylber Hyseni dhe [REDAKTUAR] me numër të biznesit [REDAKTUAR] dhe NUI 810821860 dhe pronarëve bashkëpronarëve bashkëinvestuesve bashkimit të pronave dhe kapitalit [REDAKTUAR]

[REDAKTUAR] në ngastrën kadastrale nr.10433-0 dhe personave të tjerë që mund të jenë pronar, shfrytëzues, posedues të lokaleve, banesave, garazheve, bodrumeve, suterene, shitja, transferimi i pronës pasurisë, lokale,

banesa, garazhin, depo, bodrume, për shkak se prona dysohet që është fituar me vepër penale.

Gjykata me aktvendimin e datës 30.10.2023 ka refuzuar kërkesën si të pabazuar.

Ndaj këtij aktvendimi kanë paraqitur ankesë prokuroria e shtetit dhe përfaqësuesit e palëve të dëmtuara, av. Saranda Keqekolla-Sadiku, Florim Shefqeti dhe Bedri Abdullahu.

Gjykata e Apelit me aktvendimin me numër reference PN.nr.1508/2023 të datës 18.12.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e palëve të lartpërmendura duke anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore dhe e ka kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje, vendim të pranuar me datë 19.02.2024.

Gjykata, pas pranimit të aktvendimit, duke u bazuar në sugjerimet e Gjykatës së Apelit në pjesën ku është sugjeruar që prokuroria të përmbush obligimin ligjor t'i njoftojë palët që kanë interes juridik, duke bërë përpjekje të përcaktuar me nenin 264 par.3 të KPP-së, me datë 15.03.2024, ka dërguar kërkesë për plotësim dhe korrigjim të kërkesës, kërkesë të së cilës, prokuroria me datë 22.03.2024 i është përgjigjur gjykatës duke dërguar kërkesën e përmirësuar për urdhër përfundimtar, të njëjtës i ka bashkangjitur kopjet e fletdërgesave që u janë dorëzuar të gjitha palëve që kanë interes juridik lidhur me kërkesën e përmirësuar për urdhër përfundimtar të datës 22.03.2024.

Kundërshtim ndaj kërkesës për urdhër përfundimtar ka paraqitur përfaqësuesi i palëve me interes juridik, av.Venhar Hana i cili e ka kundërshtuar kërkesën e përmirësuar të prokurorisë së shtetit për urdhër përfundimtar në emër të palëve me interes juridik dhe të tij. Ndërkaq në seancën dëgjimore e elaboroi kundërshtimin e tij në mënyrë më të detajuar, poashtu i është dhënë mundësia të gjitha palëve për të pyetur apo sqaruar pretendimet e tij.

Ndaj kërkesës së prokurorisë së shtetit pala me interes juridik Ruzhdi Hasani përmes avokatit të tij me autorizim Venhar Hana, ku përmes parashtresës ka kundërshtuar në tërësi kërkesën e përmirësuar të prokurorisë duke i'u bashkangjitur deklarimeve dhe thënieve si të palëve të treta të interesuara të paraqitura në parashtresën e datës 02.04.2024. I njëjti i ka propozuar gjykatës që të refuzojë kërkesën për lëshimin e urdhërit ndalues përfundimtar me arsyetimin se prokurori i shtetit ka dështuar të vërtetojë ekzistimin e dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumentit "RESENJE", nr.461/61 të datës 7.VIII.1961, i cili paraqet akt të humbjes e jo fitimit të së drejtës së pronësisë, pasi që nuk është argumentuar e as provuar me asnjë provë materiale dyshimi i bazuar për kryerjen e veprës penale të mashtrimit siq pretendon prokurori i shtetit, ngase të gjitha palët e tretblerësit me miëbesim (bona fides) kanë realizuar plotësisht të drejtat pronësore objekt i kontratave të shitblerjes dhe nuk janë e as që ndihen të mashtruar, si dhe nuk është plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për caktimin e urdhërit ndalues përfundimtar, pasi që palët e interesuara kanë provuar me prova materiale se pasuria në fjalë nuk është pasuri e specifikuar, ndalimi përfundimtar nuk është i nevojshëm për të ruajtur disponueshmërinë e pasurisë së specifikuar për konfiskim në të ardhmen, pasuria është në pronësi të palës së tretë dhe nuk është dhuratë e njoftosur dhe palët e interesuara-pronarët legjitim të ngastrës lëndore nuk kanë ditur e as që kanë pasur mundësi të dijnë se pasuria në fjalë është mjet i kryerjes së vepërës penale, të cilat sipas pretendimeve të avokatit janë të vetme kushtet

ligjore që duhet të plotësohen sipas ligjit, për t'u arsyetuar një ndalim i pasurisë, të cilat në rastin konkret nuk janë plotësuar.

Gjykata, meqenëse nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të palëve të tjera të interesuara dhe konfirmim se të njëjtit janë njoftuar lidhur me kërkesën e prokurorisë së shtetit, për të paraqitur kundërshtimet e tyre, e ka konsideruar të nevojshme të caktojë seancë dëgjimore, ku i ka ftuar të gjitha palët që kanë interes juridik në këtë çështje të procedurës paraprake, në bazë të kopjeve të fletdërgesave të siguruar nga prokuroria e shtetit.

Me datë 29.04.2024 ka mbajtur seancën dëgjimore ku morrën pjesë: Prokurorja e shtetit, Nebahate Salihu, përfaqësuesit e palëve të dëmtuara Gursel Sadiku dhe Nexhat Sadiku, av. Saranda Keqekolla-Sadiku, Florim Shefqeti me bashkëpunëtorin profesional në zyrën e tij dhe Bedri Abdullahu.

Ndërsa përfaqësues të palëve me interes juridik: [REDACTED]

[REDACTED] poashtu ka prezentuar [REDACTED] Vllahu, të cilin poashtu me autorizim i përfaqëson a [REDACTED] si dhe palët me interes juridik [REDACTED], [REDACTED] ndërsa nuk prezenton i dyshuari Ylber Hyseni që sipas fletkthesës rezulton se është shpërngulur nga adresa që e kemi pranuar nga prokuroria, po në bazë të kërkesës së të njëjtës, gjykata ka lëshuar urdhër arrest.

Gjykata, në seancën dëgjimore ftoi prokuroren e shtetit që ta elaborojë kërkesën e përmirësuar për urdhër përfundimtar e cila deklaroi se siç e ka bërë me shkrim ndaj të njëjtës po qëndron dhe kërkoi nga gjykata që të njëjtën ta aprovojë në bazë të provave që ka pasur në dispozicion nga prokuroria e shtetit, palët e dëmtuara dhe provat e paraqitura nga pala e interesuar, poashtu të gjitha palëve të tjera për t'u deklaruar lidhur me kërkesën e përmirësuar të prokurorisë, për të paraqitur prova të tjera që kanë të bëjnë me kërkesën e lartpërmendur.

**Prokuroria Themelore në Prishtinë**, duke i'u përgjigjur me datën 22.03.2024, ka dërguar në gjykatë kërkesën e përmirësuar për urdhër ndalues përfundimtar kundër të pandehurit Ylber Hyseni për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer Legalizimin e përmbajtjes së rreme në bazë të nenit 393, paragrafi 4, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mashtrimi në bazë të nenit 323, paragrafi 4, lidhur me nenin 77 të KPPRK-së. Në vazhdimësi dhe brenda afatit ligjor, duke u bazuar në dispozitat ligjore, prokuroria ka paraqitur këtë kërkesë dhe ka kërkuar të urdhërohet ndalimi sekuestrimi i përkohshëm i parcelës kadastrale me numër 1743-0 në Zonën Kadastrale të Prishtinës, me sipërfaqe 88.29 Ha, e cila ka pësuar ndryshimet e përmendura në kërkesë. Tutje, prokurorja e shtetit elaboron arsyet e paraqitjes së kërkesës së lejuar për urdhër përfundimtar, si në vijim: Të gjitha këto ngastra kadastrale të përmendura në kërkesë janë kërkuar të bashkohen në një parcelë të vetme e cila evidentohet me numrin 10433-0, për të cilën ekziston vendimi i datës 26.07.2022 për lejen ndërtimore për ndërtimin e kompleksit Prishtina e Re. Të gjitha këto ngastra janë blerë nga pronarët e rinj nga ish-pronari i pandehuri Ylber Hyseni dhe asetet e

vendosura në to. Prokuroria ka kërkuar ndalimin e shitjes, blerjes, tjetërsimit, qirave parblerjes dhe ndërtimit të lokaleve, banesave, garazheve dhe podrumeve në çdo pjesë të ndërtuar të pronës, e cila shtrihet si pjesë kadastrale 10433-0. Gjithashtu, prokuroria ka kërkuar që të urdhërohet komuna e Prishtinës që të mos bëjë bartje regjistrimi të tjetërsimeve që kanë të bëjnë me ngastrën me numrin e lartësuar. Prokuroria ka kërkuar që të ndalohet Ylber Hyseni, Kompania [REDAKTUAR] me numër biznesi [REDAKTUAR] dhe NI8108D, si dhe pronarët bashkëpronarë, bashkëinvestitorë, bashkimi i pronarëve dhe kapitaleve: [REDAKTUAR]

[REDAKTUAR] numrin e ngastrës 10433-10 dhe personat tjerë që mund të jenë pronarë, shfrytëzues, posedues të lokaleve, banesave, garazheve dhe podrumeve për shkak të dyshimit të bazuar se prona dyshohet se është përfituar me vepër penale. Prokuroria ka paraqitur këtë kërkesë pasi Prokuroria Themelore në Prishtinë, më datën 27.10.2022, ka filluar hetimet kundër të pandehurit Ylber Hyseni, i cili gjendet në arrati për shkak të dyshimit të bazuar në Legalizimin e përmbajtjes së rreme në bazë të Nenit 393, paragrafi 4, lidhur me Nenin 77 të KPRK-së, si dhe Mashtrimin, nga neni 323, paragrafi 4, lidhur me Nenin 77 të KPPRK-së. Prokuroria Themelore në Prishtinë, me të njëjtën numër lënde, më datën 26.08.2023, ka zgjeruar hetimin edhe kundër të pandehurit Afrim Gashi për shkak të dyshimit të bazuar në bashkëpërgjegjësinë me Ylber Hysenin për të kryer Mashtrimin, nga neni 323, paragrafi 4, lidhur me Nenin 31 të KPRK-së, si dhe Legalizimin e përmbajtjes së rreme, nga neni 395, paragrafi 1, lidhur me Nenin 31 të KPRK-së. Prokuroria ka përshkruar në mënyrë kronologjike arsyen e paraqitjes së kërkesës dhe arsyet e refuzimit nga gjykata. Pasi hetimet filluan kundër të pandehurit Ylber Hyseni dhe Afrim Gashi, dyshohet se i pandehuri Ylber Hyseni, fillimisht nga data 14.10.2014, ka paraqitur në noterin Valdete Ademi një dokument të falsifikuar, "Resenje Narodne Opstine" datë 15 Qershor 1991, broj 461-61, të datës VII 1961, duke pretenduar se është origjinal dhe më vonë, e njëjta kopje e noterizuar e ka paraqitur në gjykatë për të shërbyer në proces. Me datë 09.12.2014, me qëllim të realizimit të kontestit pronësor juridik, që kinse i njëjti kishte pasur me "NSHKBI Kosova Eksport" ai ka paraqitur një kërkesë për njohjen e të drejtës pronësore në Dhomën e Posaçme, duke e vënë në lajthim edhe gjykatën me një aktvendim gjyqësor me numër C-II-14-0140-c001, datë 14.09.2014, duke e njohur Zojën Hyseni si pronare me, sipërfaqe 9.76.26 Ha, pjesë e së cilës është edhe parcela me numër 1743, që Ylber Hyseni ka pretenduar të përfitojë. Me qëllim të përfitimit dhe me vetëdije, edhe pse e dinte se dokumenti nuk ishte origjinal, ai ka paraqitur aktgjykimin për të shërbyer në zyrën kadastrale të Komunës së Prishtinës. Bazuar në dokumentacionin e dhënë, zyrtarët kadastralë kanë ndryshuar certifikatën me numër 1194D-03.0009494, vitit 2020, duke e bërë Zojën Hyseni pronare, me pastaj i pandehuri ka vazhduar tutje dhe me qëllim të përfitimit ka vënë në lajthim edhe noterin Safedin Blakaj ku me datë 05.02.2020 pranë zyrës së tij ka paraqitur parashtresë për fillimin e procesit trashëgimor, duke u bazuar në dokumentin e paraqitur nga i pandehuri me aktvendim plotësues me numër LRP.NR.68402020 më datë 21.07.2020, në të cilin noteri ka shpallur Ylber Hyseni-n trashëgimtar të pasurisë së Zoje Hysenit. Dëshmitarë në këtë proces kanë qenë edhe Afrim Gashi, bashkëshortja Melihate Gashi dhe kështu, i pandehuri Ylber Hyseni ka paraqitur



dokumentet për institucionet e lartpërmendura duke i vënë në lajthim. Në këtë kontekst, dyshohet se nga muaji janar deri më tani, në lagjen Veternik në parcelën e shënuar me numër 1743 në Prishtinë, i pandehuri Ylber Hyseni ka vepruar me qëllim të vetëm përfitimin për të dhe për Afrim Gashi-n. Hetimet fillimisht kanë filluar me parcelizimin dhe më pas me shitjen dhe tjetërsimin e parcelave, duke përdorur informacion të rremë për pronën, siç pretendonin ankuesit Nexhat Sadiku dhe Gursel Sadiku se toka është e tyre. Prokuroria Themelore në Prishtinë ka siguruar prova materiale, duke përfshirë dokumentin e dyshuar të falsifikuar "Resenje Narodne Opstine" datë 15.06. 1961. Në bazë të këtij dokumenti, Zojën Hyseni e fiton të drejtën e pronësisë më 2015. Në raportin e ekspertizës së ekspertit gjyqësor Sedat Krasniqi, është konstatuar se nënshkrimi në emër të Milorad në dokumentin e lartpërmendur nuk është origjinal në krahasim me dokumentin e dhënë. Bazuar në faktet e paraqitura dhe për të vazhduar hetimet në këtë fazë të procesit penal, është e nevojshme që të lëshohet një urdhër ndalues përfundimtar për të ndaluar sekuestrimin e përkohshëm të ngastrës kadastrale 1743, Zona Kadastrale Prishtinë Veternik, pasi dyshohet se është fituar mbi bazën e dokumentit të falsifikuar nga i pandehuri Ylber Hyseni, dhe kjo pronë konsiderohet pasuri e përfituar nga vepra penale. Prokuroria konsideron se në këtë fazë të procesit është e nevojshme që të lëshohet një urdhër ndalues përfundimtar për parcelën 1743 në bashkimin e parcelave, ku tani figuron 10433-0, e cila dyshohet se është fituar mbi bazën e dokumentit të falsifikuar, pasi kjo pronë konsiderohet pasuri e përfituar nga vepra penale. Për të parandaluar pasoja të paparashikueshme për qytetarët, është e rëndësishme që të lëshohet ky urdhër ndalues për të shmangur dëme të mundshme për ta. Sa i përket dokumentacionit të përmendur në këtë kërkesë, që është gjetur në arkivin e shtetit me autorizimin e Prokurorit Shtetëror. Policia ka dëgjuar edhe Aziz Krasniqi-n në cilësinë e dëshmitarit. Dokumentacioni i arkivuar i prokurorisë vërteton se Aziz Krasniqi ka qenë pronar i parcelës 1743 në bazë të një kontrate shitblerjeje me numër 1743 të nënshkruar më datë 03.01.1953, midis shitësit Svetiq Todora Miloten, bujk nga Badovci dhe Aziz Mustafe Krasniqi nga Komuna e Vushtrrisë. Më pas, e njëjta pronë u hoq nga posedimi me aktvendimin me numër 54862, i cili vendos që të përfshihet në pronësi publike nga pronari Aziz Krasniqi dhe u kthye në disa ngastra kadastrale, e njëra prej të cilave është 1743, ara e klasës 5 në vendin e quajtur Veternik. Komisioni ka mbajtur seancë më 1963 dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit ka vendosur se Aziz Krasniqi ka humbur të drejtat për këtë tokë pasi është shpallur armik i popullit. Prokuroria Themelore në Prishtinë ka siguruar prova materiale, duke përfshirë dokumentin e dyshuar të falsifikuar "Resenje Narodne Opstine", datë 15 Qershor 1961. Në bazë të këtij dokumenti, Zojë Hyseni fiton të drejtën e pronësisë më 2015. Në raportin e ekspertizës së ekspertit gjyqësor Sedat Krasniqi, është konstatuar se nënshkrimi në emër të Milorad në dokumentin e lartpërmendur nuk është origjinal, në krahasim me dokumentin e dhënë. Bazuar në faktet e paraqitura dhe për të vazhduar hetimet në këtë fazë të procesit penal, është e nevojshme që të lëshohet një urdhër ndalues përfundimtar për të ndaluar sekuestrimin e përkohshëm të ngastrës kadastrale 1743, Zona Kadastrale Prishtinë Veternik, pasi dyshohet se është fituar mbi bazën e dokumentit të falsifikuar nga i pandehuri Ylber Hyseni, dhe kjo pronë konsiderohet pasuri e përfituar nga vepra penale. Prokuroria konsideron se në këtë fazë të procesit është e nevojshme që të lëshohet një urdhër ndalues përfundimtar për parcelën 1743 në bashkimin

e parcelave, ku tani figuron 10433-0, e cila dyshohet se është fituar mbi bazën e dokumentit të falsifikuar, pasi kjo pronë konsiderohet pasuri e përfituar nga vepra penale. Për të parandaluar pasoja të paparashikueshme për qytetarët, është e rëndësishme që të lëshohet kjo urdhër ndalues për të shmangur dëme të mundshme për ta. Sa i përket dokumentacionit të përmendur në këtë kërkesë, që është gjetur në arkivin e shtetit me autorizimin e Prokurorit Shtetëror, policia ka dëgjuar edhe Aziz Krasniqin si dëshmitar.

**Përfaqësuesi i palës së dëmtuar,** avokati Florim Shefqeti, lidhur me kërkesën e përmirësuar të prokurorsë së shtetit deklaroi se konsiderojnë se nga data 18.12.2022, kur kjo gjykatë ka caktuar urdhër për sekuestrim të përkohshëm deri tani, ka refuzuar një urdhër të tillë, edhe pse çdo herë ka pasur edhe më shumë prova. Pra, për mbi një vit e gjysmë, në terren, palët dhe qytetarëve u është munduar të u shkaktohen dëme, për të cilat konsiderojmë se sistemi gjyqësor duhet të mbajë përgjegjësi. Arsyeya, siç u tha më lart, është se aktgjykimi i Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme është nxjerrë me datë 14.09.2015, e cila normalisht nuk është e prerë, por sipas certifikatës së vdekjes me datë 23.09.2015, Zoje Hyseni ka vdekur dhe procesi deri në vendimin e Kolegjit të Apelit, i cili ka vendosur me 14.01.2021, është zhvilluar nga avokati Ekrem Agushi në kundërshtim me nenin 82 paragrafi 2 i cili në mënyrë ligjore përcakton që me vdekjen e autorit dhënës, pra Zoje Hyseni, pushon autorizimi për avokatin Agushi, gjithashtu edhe në kundërshtim me ligjin LPK nenin 277 dhe 282. Kjo gjykatë, ndaj të pandehurit Ylber Hyseni, sa na është informuar, ka lëshuar urdhëra arrest ndërkombëtar për veprat e njëjta, për të cilat duhet të vendos për pronën e dyshuar të fituar përmes kryerjes së veprës penale. Dhe që del se, nëse ky urdhër arresti ka plotësuar kushtet ligjore në kuptimin e masës së sigurisë, atëherë si mund të mos vlerësohet njëjtë në aspektin e masës, edhe për pronën e cila është derivat i veprave penale. Kjo konfirmon më tepër vet gjykata e Apelit në të gjitha vendimet e saj, konkretisht në datën 28.08.2023 në faqet 4, 5 dhe 6, ku ka konstatuar se kjo gjykatë asnjëherë nuk e ka vlerësuar bazueshmërinë e kërkesës, por është marrë me çështje formale, dhe kjo del të jetë e vërtetë sepse gjykata e Apelit në vendimin e datës 06.02.2020 ndër të tjera ka pranuar si të mirëqenë faktin vendimtar që ndryshimi i subjekteve titullarë të pronësisë nuk mund të paraqesë asnjë lloj baze për legjitimitimin e veprimeve kundërligjore-veprave penale. Kjo është sepse, sipas ekspertizës së gjeodezisë më datë 22.07.2021, vërehen ndryshime të cilat janë evidente edhe në terren dhe të cilat të gjitha, duke u bazuar në një vendim të cilit i ka paraprirë një akt administrativ, për të cilin eksperti i licencuar ka konfirmuar se ai dokument përmban ndryshime kompjuterike në faqen 5, dhe po ashtu, ai nuk është i nënshkruar nga zoti Filipoviq ashtu si pretendohet. Më tepër, vula e përdorur del të mos jetë origjinale për nga madhësia dhe përmbajtja e saj, duke qenë se si model i vulës së përdorur në dokumentin e përdorur nga i pandehuri, del që nuk është përdorur një model i tillë i vulave në atë kohë. Nga deklarata e zotit Kuqi dhe në policinë, konfirmohet se ai dhe i njëjti kanë blerë pronën, objekt i kësaj procesi, nga familja Sadiku. Po ashtu, konfirmohet që nga viti 2000 dhe më tej, nuk janë penguar nga askush, dhe kjo verifikohet edhe nga shkrimi i dërguar nga zoti Kuqi tek zoti Sadiku vetëm me datë 06.08.2021, ku zoti Kuqi për herë të parë është njoftuar për një person quajtur Ylber Hyseni. Po ashtu, akti noterial LRP.3003/2021, ku Ylber Hyseni si shitës është përfaqësuar nga Kujtim Kuqi



ndërsa blerësi është vëllai i tij Shkelzen Kuqi, dhe në nenin 5 të kësaj kontrate, çmimi i kontraktuar është përcaktuar të paguhet tek i autorizuari tek zoti Kujtim Kuqi nga parakontrata e lidhur pranë zyrës noteriale të zotit Sefedin Blakaj, në mes të Ylber Hyseni, të cilin e përfaqëson Afrim Gashi, ku si blerës ishte [REDAKTUAR]. Ndërsa, në mënyrë të paligjshme nga ana e noterit, konstatohet se Zoje Hyseni është pronare e ngastrës kadastrale, edhe pse në atë kohë, në vitin 2015, ende nuk ishte vendosur asnjë shkallë e parë gjykatësore, dhe prona identifikohet si pronësi publike. Të gjitha këto paraqesin dyshimin e bazuar mire se i pandehuri në këtë proces, duke bashkëpunuar me personat e tjerë, ka kryer veprat penale, si në kërkesën e prokurorisë, përmes të cilës ka arritur të përfitojë në dëm të pasurisë së të dëmtuarve. Dhe kjo me rrezikun e zgjerimit të të dëmtuarve të mundshëm që mund të ndodhin në mungesë të urdhërit të përkatës.

**Avokatja Saranda Keqekolli Sadiku** deklaroi se në kontratën e shitblerjes të cilën e përmendi kolegu Florim Shefqeti, ku Ylber Hyseni ishte përfaqësuar nga Kujtim Kuqi për të shitur tokën e tij vellaut të Shkelzen Kuqit, dhe më vonë në deklaratën e tij në polici, i njëjti kishte shpjeguar se pronari i tokës që e kishte blerë Shkelzen Kuqi me autorizim nga vëllai Kujtim Kuqi, ishte edhe vetë Kujtim Kuqi, bashkëpronar. Madje, në kontratë ishte shënuar se të hollat për blerjen e kësaj prone janë derdhur në llogarinë e Kujtim Kuqit, dhe për këto nuk ka dëshmi që janë transferuar tek Ylber Hyseni. Një fakt tjetër që gjykata duhet të ketë parasysh është se i bashkëakuzuari tjetër, Afrim Gashi, që në prokurori mban numër të njëjte të lëndës, për të njëjtin kishte kërkuar caktimin e paraburgimit pikërisht për shkak të veprës penale mashtrimi në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi me Ylber Hysenin. Ky fakt e vërteton dyshimin e bazuar se për periudhat e shitblerjes të parcelës 1743 me parakontrata noteriale, të cilat pothuajse në shumicën e tyre i ka lidhur Afrim Gashi me autorizim të Ylber Hysenit, dhe vetëm për periudhën nga data 23.12.2020 deri me datën 13.08.2021 kishte lidhur kontrata për shitblerje me autorizimin e dhënë nga Ylber Hyseni për 22 parcelat e përfituara-parcelizuara nga parcela 1743, duke përfutur shuma të larta të mjeteve. Nga kjo vlerë e mjeteve të fituara vetëm 344,878 euro janë transferuar në llogarinë e Ylber Hysenit, ndërsa të tjera janë tërhequr nga Afrim Gashi. Kjo tregon se në rastin konkret është përmbushur kushti kryesor i veprës penale mashtrimi, ku elementi kryesor është përfitimi material. Në rastin konkret, prokuroria këtë e ka bërë të besueshme me prova materiale. Edhe do të doja të ktheja vëmendjen te deklaratat e [REDAKTUAR] dhe parakontrata noteriale e cila ishte lidhur një muaj para se gjykata të njëjtit të drejtën e pronësisë Zoje Hyseni. Pra, parakontrata ishte lidhur në muajin gusht të vitit 2015 edhe përkundër faktit se prona akoma figuronte si pronë shoqërore, noterja e kishte noterizuar të njëjtën duke u thirrur se Zoje Hyseni është pronare legjitime, duke mos e cekur asnjë dokument, sepse noterja ishte bindur se Zoje Hyseni është pronare. Këto parregullsira që i cekem dhe parregullsira të tjera vërtetojnë dyshimin e bazuar. Prandaj, tani në këtë fazë është e domosdoshme që të lëshohet urdhëri ndalues përfundimtar për faktin se zvarritja e procesit gjyqësor po u shkakton dëme të mëdha qytetarëve dhe për këtë përgjegjëse kryekëput është trajtimi i lëndës nga ana e gjykatës. Gjykata duhet të ketë parasysh faktin se për këtë lëndë është caktuar një masë e sigurisë kundër të bashkëdyshuarit Afrim Gashi. Kjo do të thotë se është vërtetuar dyshimi i bazuar se është kryer kjo veprë penale, sepse elementi kryesor për caktimin e një masë të sigurisë është dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale dhe në rastin konkret, konsideroj se është plotësuar kushti se është vërtetuar dyshimi i bazuar që

gjkata të lëshoj urdhërin ndalues përfundimtar dhe përtej dyshimit të bazuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale, që i vihet në barre gjykata, mund të vendos rastin me aktgjykim të plotëfuqishëm. Prandaj, tani për tani është e domosdoshme. Në lidhje me parashtrësën që e pranuan në seancën e sotme, e cila ishte dërguar nga përfaqësuesi Venhar Hana, kërkojmë nga gjykata që përgjigjen ta kthejmë me shkrim, për faktin se nuk patëm mundësi ta analizojmë.

**Av.Bedri Abdullahu** deklaroi se nuk ka çka të shtojë.

**Avokati Venhar Hana**, lidhur me kërkesën për urdhër përfundimtar të përmirësuar nga prokuroria e shtetit, deklaroi: Palët e tjera të interesuara, të cilat në këtë çështje i përfaqësoj, e kundërshtojnë në tërësi kërkesën e lejuar për urdhër ndalues përfundimtar të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, të datës 22.03.2024, të kundërshtuar në thelb edhe në formë të shkurtuar të parashtrësës të datës 03.03.2024, duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Provat materiale në mbështetje të kësaj kërkesë nuk plotësojnë as standardin minimal të dyshimit të bazuar se janë kryer veprat penale të falsifikimit të ndonjë dokumenti mashtrimi, respektivisht, mbi të cilin dokument supozohet të jetë fituar një e drejtë pronësie nga Ylber Hyseni. Fakti se dyshimi i bazuar nuk ekziston fare vertetohet edhe me provën materiale që prokurorja Salihu ka në dispozicion nga data 06.02.2024, pra para paraqitjes së kërkesës së lejuar të datës 22.03.2024, respektivisht ekspertizën e nxjerr në rrugë zyrtare e të punuar nga Instituti i Forenzikës, në të cilën theksohet se nga ekzaminimi i dokumentit "Resenje" të vitit 1961 "nuk është arritur në ndonjë rezultat përfundimtar dhe se rezultati është - pa konkluzion". Mirëpo, më tej përveç në kërkesën e lejuar por edhe në seancën e sotme dëgjimore, prokurorja referohet në ekspertizat forenzike të kryera në rrugë private nga pretendues të të drejtës së pronësisë në ngastrën lendore, dhe sic duket, të njëjtave me shumë i'u fal besimi se sa provave të verifikuara të cilat ajo siguron zyrtarisht. Për më shumë lidhur me pretendimin e falsifikimit të dokumentit të vitit 1961, prokurorja pretendon se i dyshuari Ylber Hyseni ta ketë përdorur të njëjtin në çështjen gjyqësore pranë Dhomës së Posacme, në shenjen C-II-14-0140-c0001, ku e paraqet si palë me legjitimet aktiv në procedurë, dhe që në fakt legjitimitetin aktiv e kishte pasur nënë e tij tani e ndjerë, Zoje Hyseni, e cila ishte përfaqësuar nga përfaqësuesi i autorizuar Ekrem Agushi. Nga përfaqësuesit e palëve të dëmtuara u aludua në shkeljet procedurale si më sipër, ku u theksua se Zoje Hyseni kishte ndërruar jetë, ndërsa shkelja qëndronte në veprimet e avokatit Ekrem Agushi si përfaqësues, mirëpo në heshtje u la se cilat veprime procedurale i përfaqësuesit në fjalë ishte marrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarit dhe Ligjit të Prokurorisë së Kosovës, ku lënda ishte në trajtim sipas ankesës së palës kundërshtare dhe jo të përfaqësuesit të autorizuar. Duhet theksuar përsëri se kërkesa e paraqitur në datën 22.03.2024 është karakterizuar nga shumë meta formale dhe materiale, duke mos përfshirë të gjithë personat e interesuar në këtë kërkesë dhe duke ngatërruar tërësisht pronarët në të drejtat e pronësisë në ngastrën nr. 10433-0 ZK Prishtinë, duke lënë pa emërtuar me emra pronarët për 28 ngastrat kadastrale që derivojnë nga ngastra 1743 ZK Prishtinë. Në përputhje me përmbajtjen e kërkesës së paraqitur nga prokuroria, objekti i kërkesës për urdhër ndalues përfundimtar paraqitet saktësisht ngastra numër 10433-0 ZK Prishtinë, e cila ka vetëm 71 ari sipërfaqe dhe ku po

kryhen investime sipas lejes ndërtimore. Megjithatë, nga mbledhja e sipërfaqeve të paraqitura në kërkesë, rezulton se objekti i njëjtë ka sipërfaqe prej 2 hektarësh, 17 ari dhe 20 metra katrorë, që nuk konsiston fare me sipërfaqen e plotë të ngastrës 1743. Nëse shohim kërkesën e drejtuar ngastrës 10433-0, supozohet se është bërë bashkimi i të gjitha ngastrave të ndara nga ngastra 1743, rezulton se nga emrat e trajtuar si persona me interes në kërkesë dhe që i'u referohen ngastrës 10433-0, përfaqësojnë vetëm sipërfaqe prej 46 ari dhe 84 metra. Në bazë të kësaj, shihet se fokusi i kërkesës është drejtuar shprehimisht ngastrës 10433-0, ku po kryhen investimet në ndërtim, duke tentuar kështu që të paraqitet si qëllim kryesor pengimi i investitorit, shkaktimi i dëmeve financiare dhe prishja e imazhit dhe dëmtimi i pronarëve të ligjshëm të pasurisë, më shumë se sa ndjekja e vënies së drejtësisë në vend. Në këtë seancë dëgjimore, nga asnjë palë nuk u fol për përmbajtjen e dokumentit "Resenje" të vitit 1961, mbi të cilin supozohet se është fituar e drejta e pronësisë tani nga i dyshuari Ylberi Hyseni. Në këtë rast, kërkoj që prokuroria të na japë në shikim këtë dokument dhe ta lexojë përmbajtjen e të njëjtit para gjykatës, duke pritur me interes që sipas këtij dokumenti, Zoje Hyseni të ketë fituar një drejtë pronësie në ngastrën 1743 ose edhe në ngastrat e tjera që përmenden në këtë dokument - të cilin prokuroria e konsideron të falsifikuar ndërsa është po i njëjti dokument që siguron të drejtën e pronësisë së Zoje Hyseni edhe në gjashtë ngastrat e tjera. Megjithatë, asnjë veprim hetimor ose procedural nuk po zhvillohet në drejtim të tyre. Prokurorja Salihu ka vazhdimisht paraqitur Nexhatin dhe Gursel Sdikun si palë të dëmtuara, ndërsa për të njëjtat ata kanë përpunuar disa parashtresa duke i trajtuar edhe si pronarë të ngastrës 1743 duke anashkaluar tërësisht faktin material që pretenduesit në fjalë tashmë kishin kërkuar mbrojtje gjyqësore duke paditur GBI "Kosova eksport" pranë dhomës së Posacme për të realizuar pretendimin e pronësisë. Gjykata ka vendosur me vendim të formës së prerë SCC-10-0353 me të cilin është refuzuar padia për vërtetimin e pronësisë për Nexhatin dhe Gursel Sdikun. Prandaj, çdo pretendim i prokurorit të shtetit në raport me dokumentin e kontestuar "Resenje" nuk ka efekt në të drejtat pretenduar nga Nexhati dhe Gursel Sadiku, dhe rezulton se vendimmarrja në këtë rast nuk është ndikuar fare nga dokumenti "Reshenje" ose dokumente të tjera. Pas kthimit të çështjes në rivendosje për herën e pestë, prokurorja në kërkesën e lejuar ka njoftuar se ka siguruar prova të reja materiale. Sipas tyre, ngastra kadastrale 1743 kishte qenë në pronësi të një pale Aziz Krasniqi, i cili kishte blerë këtë pronë nga shitësi Milutin më datën 03.01.1951, një fakt që u vërtetua në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më datën 04.01.1953. Po ashtu, paraqitet edhe vendimi i Kuvendit Komunal Prishtinë 548/62 i datës 30.09.1963, sipas të cilit supozohet se Aziz Krasniqi është zhveshur nga e drejta pronësore e tij, pasi sipas aktgjykimit të Gjykatës Popullore të rrethit të Prishtinës më 24.05.1951, Aziz Krasniqi është dënuar me burgim të përjetshëm dhe është shpallur armik i popullit. Nga analiza e provave të reja të siguruara nga prokuroria, rezulton se kontrata e shitblerjes e datës 03.01.1953 është lidhur në ditën e shtunë, por është vërtetuar një ditë më vonë në Gjykatën e Qarkut në ditën e diel me datën 04.01.1953, një fakt që tregon se ky pretendim është i pavërtetë. Pas rikthimit të dispozitivit të aktgjykimit penal të Gjykatës Popullore të rrethit të Prishtinës të datës 24.05.1951, rezulton se Aziz Krasniqi, i shpallur si armik i popullit dhe i dënuar me dënim të përjetshëm, i humbi të drejtat e lirisë, të drejtat politike dhe qytetare përhershëm, si dhe shtetësinë e Jugosllavisë. Kjo do të thotë se, si person fizik,



Aziz Krasniqi nuk kishte zotësi të veprimit dhe nuk gëzonte asnjë të drejtë për të hyrë në marrëdhënie juridike civile. Analiza e provave të siguruara nga prokuroria tregon se kemi një fletë poseduese të datës 02.01.1953 në emër të Milutin Steviq, dhe asnjë dokument të tillë që tregon pronësinë në emër të Aziz Krasniqit. Në lidhje me vendimet e dhomës së posaçme për Nexhatin dhe Gurselin Sadiku, prokurorja shmang aktgjykimin duke përdorur dy vendime gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjen e Aziz Krasniqit. Megjithatë, nuk trajtohet në mënyrë të përsëritur vendimi aktual i çështjes AC-I-22-0101 datë 02.03.2023, i cili tregon se padia e Aziz Krasniqit ishte e pa bazuar dhe u hodh në tërësi. Përveç kësaj, prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë ekzistimin e dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumentit, i cili supozohet të jetë dokumenti i fitimit të të drejtës së pronësisë, ndërsa në fakt është dokumenti i humbjes së saj. Në mungesë të provave materiale, dyshimi për kryerjen e mashtrimit gjithashtu nuk është argumentuar ose provuar. Palët e interesuara kanë vërtetuar me prova materiale se ngastër 10433-0 nuk paraqet pasuri të specifikuar, dhe se nuk ka pasur dijeni për ndonjë hetim penal në kohën e blerjes. Sipas tyre, kjo pasuri duhet të mos përfshihet në ndalim të përfundimit sipas kërkesës së prokurorisë, për shkak të mungesës së provave për dyshimin e bazuar për vepra penale. Në rikthim kërkojmë nga gjykata të mundësojë leximin e dokumentit "Resenje" të vitit 1961 nga prokuroria e shtetit, për të kuptuar nëse ka përmbajtjen e fitimit të të drejtës së pronësisë ose humbjes së saj, dokument që është në gjuhën serbe.

**Palët me interes juridik, Besnik Shala dhe Granit Krasniqi** kundërshtojnë kërkesën e prokurorisë për bllokimin e pronave, duke theksuar se kanë blerë tokën në mënyrë plotësisht ligjore dhe nuk kanë hasur probleme deri më tani. Ata deklarojnë se kanë dokumentacionin e nevojshëm, si kontratën, pagesën përmes bankës dhe noterit, dhe nuk kanë marrë asnjë informacion për ndonjë problem lidhur me pronën e tyre.

Pala me interes juridik, Besnik Shala shton se ka tri vjet që ka blerë pronën dhe nuk ka pasur asnjë problem deri para disa muajsh, kur është thirrur nga policia për të dhënë dokumentacionin e pronësisë. Në anën tjetër, Grani Krasniqi gjithashtu thekson se ka blerë pronën në mënyrë ligjore dhe nuk është informuar për ndonjë problem deri më tani.

**Ragip Vllahu** e mbështet fjalën e përfaqësuesit të tij, Venhar Hana, në mbështetje të palëve të tyre.

Pas mbajtjes së seancës dëgjimore, avokatja Saranda Keqekolla-Sadiku, ka kërkuar nga gjykata që pas kësaj seance të paraqes kundërshtim ndaj kundërshtimit të av. Venhar Hana, si përfaqësues i palëve të interesuara pasi që prokuroria gjatë seancës së djeshme ka theksuar se të dhënat lidhur me parcelën 1743, i ka siguruara në mënyrë zyrtare nga zyra ligjore për Gjeodezi dhe Kadastër dhe konsideron që këto të dhëna zyrtare nga institucioni përkatës duhet të merren të besueshme nga ana e gjykatës sepse vet fakti që përfaqësuesi i palës me interes është thirrur në mënyrë të vazhdueshme se kinse nuk janë të specifikuar, e ka bërë që gjykatën ta vë në lajthim sa i përket pasurisë së specifikuar e cila dyshohet se është fituar prej veprës penale "Legalizimi i përmbajtjes së rremë" nga neni 395 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me nenin 77 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nga i dyshuari Ylber Hyseni në bashkëkryerje me Afrim Gashi,

avokatja tutje deklaroj se meqenëse kundërshtimit i ka bashkangjitur aktgjykimet dhe aktvendimet e Gjykatës Supreme të Kosoës, e vejnë në dije se të gjitha këto procedura janë zhvilluar pa qenë Dhoma e Posaçme në dijëni se është mbështetur në dokumente të falsifikuara.

Ndërsa sa i përket përfaqësuesit të autorizuar të palëve me interes, av.Venhar Hana, cili në seancën e datës 29.04.2024, gjykatën e vë në dijëni se i njëjti është pronar në njërën nga parcelat 1743, e pos kësaj avokatja shtoi se avokati Venhar Hana nuk e ka pranuar se e ka përfaësuar Ylber Hyseni në procedurat e tjera, duke i bashkangjitur një provë, kopje të autorizimit të noterizuar të Venhar Hana-s, i datës 02.12.2020.

Gjykata, pas shqyrtimit të kërkesës për urdhër ndalues përfundimtar, duke marr parasysh sugjerimet dhe vërejtjet e kolegjit të Gjykatës së Apelit me numër PN.nr.1508/22 të datës 30.10.2023, poashtu duke analizuar me kujdes të gjitha provat e sjella nga palët, si në vijim:

-Raportin e ekspertizës së datës 03.08.2022, të ekspertit gjyqësor Sedat Krasniqi, është konstatuar se nënshkrimi në emër të Milorad Filipovic në dokumentin “RESENJE” Broj 461/61 i datës 7.VIII.1961, nuk është nënshkrim origjinal i tij, krahasuar me modelet e vëna në dispozicion.

-Me ekspertizën teknike të shenjave të vulave të datës 19.08.2022 sipas konkluzionit të kësaj ekspertize, shenjat e vulës në dokumentin e, objekt ekspertimini “RESENJE”, Broj 461/61, i datës 7.VIII.1961, nuk është formuar nga vula me të cilën janë formuar shenjat e vulave në dhjetë dokumente krahasuese, po është formuar nga një tjetër vulë.

-Fleta poseduese P-P-71914059-10433-0, për pronën në pronësi të [REDAKTUAR]

-Leja Ndërtimore e lëshuar nga Komuna e Prishtinës Nr.05NR. 351/02-40564/22 të datës 26.07.2022;

-Certifikata e biznesit për LIRIMI&ACL sh.p.k;

-Autorizimi për përfaqësim të subjektit LIRIMI&ACL sh.p.k.

-Aktgjykim i Kolegjit të Specializuar i Gjykatës Supreme të Kosovës (Dhoma e Posaçme) me numër C-II-14-0140-C0001 i datës 14.09.2015;

-Aktgjykim i Kolegjit të Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës (Dhoma e Posaçme) me numër SCC-10-0353 i datës 19.12.2017; i cili është vertetur me vendimin AC-I-18-0026, datë 22.08.2019;

-Aktvendim i Kolegjit të Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës (Dhoma e Posaçme) m numër AC-I-18-0026 i datës 14.01.2021.

-Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.189/21 i datës 12.01.2022;

-Aktvendim i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.888/21 i datës 01.03.2022;

-Aktvendim i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.294/2022;

-Aktvendim i Kolegjit të Apelit i Gjykatës Supreme;

-Aktvendim për papranueshmëri me numër reference:RK 1551/20 i datës 21.04.2020m, për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0212-A0001, të datës 22.08.201.

-Palët e dëmtuara, Gursel Sadiku dhe Nexhat Sadiku përmes përfaqësuesve të autorizuar dhe atë: Avokate Saranda Keqekolla Sadiku, av.Bedri Abdullahu dhe Av.Florim Shefqeti kanë paraqitur prova pas paraqitjes së kërkesës nga prokuroria e shtetit të datës 26.05.2023, duke e arsyetuar lëshimin e urdhërit ndalues të përkohshëm dhe kanë kërkuar që gjykata të lëshojë urdhër ndalues përfundimtar me pretendimin e tyre se ka arsye që të caktohet kjo masë pasi që sipas përfaqësuesve të palëve të dëmtuara Nexhat Sadiku dhe Gursel Sadiku, nga të dhënat që kanë siguruar nga Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Kadastrit, pretendojnë që pronat e fituara janë derivat i veprave penale, dhe fitimi i të drejtës së pronësisë është bërë nga veprat penale që në bazën dhe gjenezën e saj, siq argumentohet përmes dy ekspertizave nga eksperti i licencuar gjyqësor, dhe atë vula dhe nënshkrimi është bërë me shkelje dhe syshime për vepra penale, si në vijim: Parcela kadatrale me nr.1743-0 ZK Prishtinë me sipërfaqë 28829m2 para vitit 1999, në programin e quajtur bormën, në të dhënat që disponon Drejtoria për Kadastër në Prishtinë, parcela kanë qenë në emër të Pik Kosovo Export. Këto të janë janë vetëm nga sistemi elektronik, ndërsa të dhëna të tjera para vitit 1999 (para luftës), nuk i kemi për arsye se ato gjenden në Serbi (Shtojca 1).Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër në Prishtinë nr.011-463-2/3802/19 të datës 13.01.2020 parcela kadatrale nr.1743-0 Zk Prishtinë me sipërfaqe 28829 m2 ka kaluar në emër të Zojë Hyseni (Shtojca 2), duke u bazuar në Aktgjykimin e lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Ksooves me nr.C II-14-0140-C001 i plotfuqishëm me datë 22.08.2020. Në bazë të kërkesës nga Aziz Krasniqi, përfaqësuar nga av.Haxhi Millaku është vendosur vërejtja në parcelën kadatrale nr.1743-0 Zk, Prishtinë, (Shtojca 7), duke u bazuar në kërkesën nga av.Haxhi Millaku të datës 07.08.2020 (shtojca 8)Autorizimi i dhënë nga Aziz Krasniqi i datës 07.08.2020 (Shtojca 9). Ne bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011463-2/1699/20 të datës 05.10.2020 paravela kadatrale nr.1743-0 Zk. Prishtinë me sipërfaqe 28829 m2 ka kaluar në emër të Ylber Hyseni (Shtojca 10) duke u bazuar në aktvendimit e trashëgimisë noterizuar nga notes Sefedin Blakaj me nr.Lrp6840/2020, Nr.ref.T.nr.1559/2020 (Shtojca 11) Certifikata e vdekjes me nr.Serik V 10344894 e datës 07.08.2020 (Shtojca 12), Kërkesa për regjistrimin e paluajtshmërisë (Shtojca 13), Aktvednimi i lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me nr.Reference 03/1829-20 i datës 08.08.2020 (Shtojca 14). Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria



E kadastrit nr.011-016/01-0198567/20 të datës 30.10.2020. Në bazë të kërkesës së Nexhat Sadiku është bendosur vërejtja në parcelën kadastrale nr.1743-0 Zk. Prishtinë me sipërfaqe 28829m<sup>2</sup>. (Shtojca 15) kërkesa për vërejtje nga Nexhat Sadiku dhe Gursel Sadiku e datës 28.10.2020,(Shtojca 16), Kallëzimi Penal i datës 27.10.2020.(Shtojca17), Propozimi për caktimin e masës së përkohshme të datës 20.05.2003 (shtojca 18).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-016/01-0220838/20 të datës 10.12.2020, në bazë të kërkesës së Ylber Hyseni përfaqësuar nga Venhar Hana është bërë fshirja e vërejtjes në parcelën kadastrale nr,1743-0 Zk Prishtinë, (shtojca 19) kërkesa për heqjen e vërejtjes në ngastrën kadastrale nr.1743-0 k. Prishtinë të datës 30.11.2020 nga av.Venhar Hana (Shtojca 20) Autorizimi vertetur nga noter Sefedin Blakaj nr.Lrp.13486/2020 (Shtojca 21) si dhe pjesa tjetër e lëndës (Shtojca 22).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.0111-940/01-0214461/20 të datës 16.12.2020. parcela kadastrale nr.17430-0 me sipërfaqe 28829 m<sup>2</sup> Zk.Prishtinë, parcelizuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr.1743-0, 1743-1,1743-2, 1743-3, 14743-4, 1743-5, 1743-6, 1743-7, 1743-8, 1743-9, 1743-10, 1743-11,1743-12, 1743-13, 1743-14, 1743-15, (Shtojca 23), manuali i ndarjes, ( Shtojca 24), si dhe pjesa e lëndës (shtojca 25), Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga drejtoria për Kadastër nr.011-463—2/11/210 të datës 18.01.2021 parcela kadastrale nr.1743-1 Zk Prishtinë, ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (Shojca 26) duke u bazuar në Kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë noterizuar nga notere Valdete I. Ademi me nr. Të Lp-së.6266/2020 nr. Refer.1433/20220 të datës 23.12.2020 (Shtojca 27), Autorizimi noterizuar nga notere Valdete I. Ademi me nr.Lrp.6214/2020 të datës 21.12.2020, (Shtojca 28) transferi bankar në shumë prej 85000.00 Euro të datës 23.12.2020 (shtojca 29) kërkesa për regjistrim, (shtojca 30) deklarata e transferit bankar (shtojca 31).Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0025524/21 të datës 15.02.2021 parcela kadastrale nr.1743-2 Zk Prishtinë, është parcelizuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr.1743-16 dhe 1743-17 Zk Prishtinë. Ka kaluar në emër të [REDAKTUAR], (Shtojca 34) duke u bazuar mbi kontratën e shitblerjes së tokës –parcelës noterizuar nga notere Valdete I Ademi me nr.Lrp-së6340/2020 dt.29.12.2020, (shtojca 36), transferi bankar dr.27.03.2017, (shtojca 37) kërkesa për regjistrim (shtojca 38), deklarata e transferit bankar (shtojca 39).Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0216686/21 dt.03.11.2021 parcela kadastrale 1743-3 Zk Prishtinë është parcelizuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr. 1743-41 dhe 1743-42 Zk. Prishtinë (shtojca 40) manuali. (Shtojca (41)Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadatrit nr.011-463-25/384/21 të dt.16.02.2021 parcela kadastrale nr.1743-4 Zk.Prishtinë ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (Shtojca 42) duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen e tokës parcelës noterizuar nga noter Valdete I Ademi me nr.Lrp.396/2021 nr. Ref.117/2021 të dt.28.01.2021 (shtojca 43).Trandferi bankar(shtojca 44) Autorizimi noterizuar nga Valdete I Ademi me nr. Te Lrp 6340 /2020 dr.29.12.2020 (Shtojca 45) kërkesa për regjistrim (shtojca 46) drkalrata e transferit bankar (shtojca 47) .Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadatrit nr.011-940/01-0216686/21 dr.03.11.2021 parcela kadastrale 1743-4 Zk Prishtinë është parceliazuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr.1743-38 dhe 1743-39 dhe 1743-40 Zk Prishtinë, si dhe pjesa tjetër e lëndës (shiko shtojcat 40, 41) .

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/1270/21 dr.07.05.2021 parcela kadastrale 1743-5 Zk Prishtinë ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (Shtojca 48). Duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen e tokës parcelës noterizuar nga

notere Valdete L .Ademi me nr. Të Krp-së:1159/2015 nr.Ref. 325/2021 (Shtojca 49), parakotnata e noterzuar nga noteree Valdete I. Ademi me nr. Te LRp1159/2015, nr. Ref. 448/2021 dr.24.08.2015 (Shtojca 50), autorizimi i noterzuar nga noter Valdete I.Ademi me nr.të Lrp-së:1370/2021 dt.22.03.2021 (shtojca 51) transferet bankare (Shtojca 52) kërkesa për regjistrim (shtojca 53), dekalrata e transferit bankar (Shtojca 54)

Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/1270/21 dr.13.08.2021 parcela kadastrale 1743-5 Zk Prishtine, pjesa e pronës prej 500/1600 m2 ka kaluar në emër të Vennhar Hana (shtojca 55) duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen nga pjesa ideale ne patundshmeri dhe themelimin e bashkepronësisë noterizuar nga noter Sefedin Blakaj mr nr.Lrp:10168/2021 nr. Ref.2633/2021 dt.02.07.2021(shtojca 56) transferet bankare (shtojca 59).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940-01-0216686/21, dt.03.11.2021 parcela kadastrale 1743-5 Zk Prishtine është parcelizuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale 1743-32,1743-33 dhe 1743-32 Zk Prishtinë. Si dhe pjesa tjetër e lëndës shiko shtojcat 40,41).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2, 1245/21 dt.11.05.2021 parcela kadastrale nr.1743-7 pjesa e pronës prej 800/121 ,mr ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (shtojca 71) duke u bazuar në kontratën e këmbimit të paluajtshmërisë (Shtojca 87) duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen e tokës së parcelizuar noterizuar nga noter Valdete I. Ademi mr nr., LRP 270/2021, nr.Ref:85/2021 dt.21.01.2021( shtojca 88) transferi bankar (shtojca 89) autorizimi noterizuar nga noter Valdete I.Ademi Lrp:6340/2020 dt.29.12.2020 (Shtojca 90), kërkesa për regjistrim (Shtojca 91) Dekalrata e transferit bankar (shtojca 92) .Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga drejtoria e kadastrit nr.011-463-2/219/22 dt.01.02.2022 parcela kadastrale nr.1743-11 ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (shtojca 95), duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë noterizuar nga noter Valdete I Ademi me nr. LRP: 7400/2021nr.1702/2021 dt.31.12.2021 (shtojca 96) transferi bankar (Shtojca 97) kërkesa për regjistrim (Shtojca 98) deklarata e transferit (shtojca 99).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0250314/22 dt. 17.11.2022 parcela kadastrale nr.1743-11 është parcelizuar dhe janë krijuar parçe;at kadastrale nr.1743-12, pjesa 100/1000 m2 ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (shtojca 103). autorizimi noterizuar nga noter Valdete I.Ademi Lrp:1377/2021 dt.22.03.2021, (Shtojca 104), transferi bankar (Shtojca 105),kërkesa për regjistrim (Shtojca 106) Dekalrata e transferit bankar (shtojca 107).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/2022/21 dt. 21.06.2021 parcela kadastrale nr.1743-12 Zk.Prishtinëpjesa e pronës prej 200/1000 m2 ka kaluar në emër të Miri Sh.p.K (shtojca 108), duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen e tokës parcelës së noterzuar nga noter Valdete I.Ademi me nr. Të LRP:2604/2021 nr.ref.638/2021 dt.24.05.2021 (Shtojca 109), autorizimi noterizuar nga noter Valdete I.Ademi Lrp:1377/2021 dt.22.03.2021, (Shtojca 110), transferi bankar dt.25.05.2021(shtojca111), kërkesa për regjistrim (Shtojca 113) Deklarata e transferit bankar (shtojca 112).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/2836/21 dt. 20.08.2021 parcela kadastrale nr.1743-12 Zk.Prishtinë, pjesa e pronës prej 200/1000 m2 ka kaluar

në emër të [REDAKTUAR] (shtojca 114), duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen e tokës parcelës së noterzuar nga notere Valdete I.Ademi me nr. Të LRP:4377/2021 nr.ref.1053/2021 dt.03.08.2021 (Shtojca 115), autorizimi noterizuar nga notere Valdete I.Ademi Lrp:1377/2021 dt.22.03.2021, (Shtojca 119), transferi bankar dt.05.08.2021(shtojca118), kërkesa për regjistrim (Shtojca 116) Deklarata e transferit bankar (shtojca 117).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/23015/21 dt. 20.09 2021 parcela kadastrale nr.1743-12 Zk.Prishtinë, pjesa e pronës prej 500/1000 m2 ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (shtojca 120), duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen e tokës parcelës së noterzuar nga notere Valdete I.Ademi me nr. Të LRP:4619/2021 nr.ref.1110/2021 dt.13.08.2021 (Shtojca 121), transferi bankar dt.05.08.2021(shtojca 122), Deklarata e transferit bankar (shtojca 123), kërkesa për regjistrim (Shtojca 124), autorizimi noterizuar nga notere Valdete I.Ademi Lrp:1377/2021 dt.22.03.2021, (Shtojca 125).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0250304/22 dt.17.11.2022 parcela kadastrale 1743-12 është parcelizuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale=nr.1743-64, dt.20.04.2022 është vendosur barra tatimore në parcelën kadastrale nr.1743-12 (shtojca(126), në bazë të kërkesës nga Atk me nr.8996 dt.19.04.2022 (shtojca 127). Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/23015/21 dt. 20.09 2021 parcela kadastrale nr.1743-12 Zk.Prishtinë, pjesa e pronës prej 500/1000 m2 ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (shtojca 120), duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen e tokës parcelës së noterzuar nga notere Valdete I.Ademi me nr. Të LRP:4619/2021 nr.ref.1110/2021 dt.13.08.2021 (Shtojca 121), transferi bankar dt.05.08.2021(shtojca 122), Deklarata e transferit bankar (shtojca 123), kërkesa për regjistrim (Shtojca 124), autorizimi noterizuar nga notere Valdete I.Ademi Lrp:1377/2021 dt.22.03.2021, (Shtojca 125).

-Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-016/01-0084875/22 dt.20,04.2022 është vendosur barra tatimore në nastrën kadastrale 1743-12 (shtojca 126).

-Në bazë të kërkesës nga Atk me nr.8996 të dt.19.04.2022 (shtojca127). Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrale nr.011-463-2.1439/21 dt.06.05.2021 parcela kadastrale nr.1743-13 Zk.Prishtinë ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] Shtojca 130) duke u bazuar në kontratën e këmbimit të patundshmërisë noterizuar nga notere Valdete I. Bajrami me nr. LRP"1860/2021 nr.Ref:458/2021 dt.15.04.2021 (Shtojca 131).Autorizimi noterizuar nga notere Valdete I.Ademi me nr.LRP"1381/201 dt.22.03.2021 (Shtojca 132), kërkesa për regjistrim (shtojca 133),.Në bazë të aktvendimit të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër nr.011-463-2/2013/21 dt.21.06.2021 parcela kadastrale 1743-13 zk.Prishtinë ka kaluar në emër të Lindita Bajrami (shtojca 134) duke u bazuar në kontratën për dhuratën noterizuar nga notere Valdete I.Ademi me nr.LRP:2827/2021 Nr.Ref.697/2021 dt.04.06.2021, (shtojca 135) kërkesa për regjistrim (Shtojca 136). Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0250328/22 dt.17.11.2022 parcela kadastrale nr.1743-13 është parcelizuar dhe janë krijuar parcela kadastrale nr.1743-64,1743-65, 1743-66, 1743-67,1743-68 dhe 1743-69 (shtojca 137) manuali i ndarjes (shtojca 138). Në bazë të aktvednimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/3260/21 dt.14.09.2021 parcela kadastrale nr.1743-15 Zk, Prishtinë ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] Shtojca 139 duke u bazuar në Kontratën për shitblerjen e paluajtshmërisë noterizuar nga notere Merita Kostanica Ukaj me nr.Lrp:1524/2021.



Nr.ref.478/2021 dt.25.03.2021 (shtojca 140), transferi bankar dt.30.08.2021 (Shtojca 141), autorizimi noterizuar nga notere Valdete I.Ademi Lrp:6194/2020 (Shtojca 142), kërkesa për regjistrim, (Shtojca 143) deklarata e transferit bankar (Shtojca 144),.Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr..011-463-2/169/21 dt.08.06.2021 parcela kadastrale nr.1743-16 ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (Shtojca 145) duke u bazuar në kontratën për shitblerjen e tokës-parcelës së noterizuar nga notere Valdete I.Ademi me nr. Të Lrp.1218/2021, nr.ref.300/2021 dt.15.03.2021 (Shtojca 146), transferet bankare (Shtojca 147) kërkesa për regjistrim (Shtojca 148),deklarata e transferit bankar (Shtojca 149), Autorizimi i noterizuar nga notere Valdete I. Ademi me nr. Të Lrp:1365/2021 dt.22.03.2021 (Shtojca 150) Ankes Kontrata e noterizuar nga notere Valdete I.Ademi me nr. Lrp:2637/2021, nr.Ref.643/2021 dt.25.05.2021 (Shtojca 151).Deklarata nën betim noterizuar nga notere Valdete I.Ademi me nr. Lrp:2006/2021 dt.26.04.2021 (Shtojca 152). Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01 14259/21 dt.29.07.2021, parcela kadastrale nr.1743-16 është parcelizuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr.1743-24,1743-25(Shtojca 153) manuali (Shtojca 154) Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr,011-463-2/1215.21 dt.19.04/2021 parcela kadastrale nr.1743-17 Zk Prishtinë ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (Shtojca 155) duke u bazuar në Kontratë mbi shitblerjen e tokës-parcelës së noterizuar nga notere Valdete I.Ademi me nr. Të Lrp:1181/2021, nr.ref:288/2021 dt.12.03.2021 (Shtojca 156) transferi bankar në shumë prej 50.000,00 Euro (Shtojca 157) kërkesa për regjistrim (Shtojca 158)Deklarata e transferit bankar (Shtojca 159).Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr..011-940/01-0216686/21 dt.03.11.2021, parcela kadastrale nr.1743-17 është parceluar dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr.1743-43, 1743-44 dhe 1743-45 Zk. Prishtinë si dhe pjesa tjetër e lëndës (Shiko shtojcat 40,41).Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/2411/21 dt.17.08.2021, parcela kadastrale nr.1743-18 ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (Shtojca 160) duke u bazuar në kontratë të këmbimit të parcelës me vetuorë noterizuar nga Valdete I.Ademi me nr.Lrp:341720211 Nr.ref867/2021 dt.30.06.2021 (Shtojca 161).Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/48/22 dt.19.01.2022.Parcela kadastrale nr.1743-18 ka kaluar te [REDAKTUAR] ndërsa parcela kadastrale nr.1743-24 në emër të Besnik Shala (Shtojca 162) duke u bazuar në Kontratë për këmbim të paluajtshmërive noterizuar nga noter Sefedin Blakaj me nr.Lrp”118894/2021, Nr.Ref.5287/2021 dt.16.12.2021 (Shtojca 163) kërkesa për regjistrim(Shtojca 164), Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/1707/21 dt.26.05.2021 parcela kadastrale nr.1743-19 Zk. Prishtinë ka kaluar në emër të [REDAKTUAR] (Shtojca 165) Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë noterizuar nga noter Sefedin Blakaj me nr.Lrp:5949/2021 Nr.Ref.1570/2021 dt.23.04.2021 (Shtojca 166). Autorizimi noterizuar nga noter Isak Ademi me nr.të Lrp:5021/2016 Nr.Ref.908/16 dt.02.03.2016 (Shtojca 167), transferi bankar (Shtojca 168), kërkesa për regjistrim (Shtojca 169), deklarata e transferit bankar (Shtojca 170). Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0216686/21 dt.03.11.2021 parcela kadastrale nr.1743-20 është parcelizuar dhe janë krijuar parcela kadastrale 1743-50,1743-51. 1743-52, 1743-53 (Shtojca 171), manuali i ndarjes (Shtojca 172).Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-01494693/22 dt.04.07/2022 parcelat kadastrale 1743-21,1743-23, 1743-26, 1743-28, 1743-29, 1743-31,1743-32, 1743-34, 1743-35, 1743-37, 1743-38, 1743-40, 1743-42, 1743-43, 1743-49 kanë kaluar në emër të Komuna e Prishtinës (Shtojca 173) kërkesa për ndryshim në regjistria kadastral me nr.13.4464/01-267200/21 dt.09.06.2022 (Shtojca 175), Vendimi nga Drejtoria e Urbanizimit me nr. 05.N.:350/02-109821/21 dt.22.07.2021 (Shtojca 176).Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr,011-463-2/5109/21 dt.17.01.2022

është bërë krijimi i bashkëpronësisë në parcelat kadastrale nr.1743-22, 1743-27,1743-30,1743-33, 1743-36, 1743-39, 1743-41, 1743-45,1743-46-, 1743-48 (shtojca 177) duke u bazuar në Kontratën për bashkimin e parcelave dhe krijimin e bashkëpronësisë së noterizuar nga noter Sefedin Blakaj nr.Lrp: 18972/2021, Nr.Ref:5324/2021 dt.17.12.2021 (Shtojca 178). Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0010182/22 dt.21.01.2022 janë bashkuar parcelat kadastrale nr.1743-27, 1743-27, 1743-301743-33, 1743-36,1743-39,1743-41, 1743-45, 1743-26, 1743-48,1743-12 dhe 1743-22 për tu krijuar parcela kadastrale nr.10433-0 Zk Prishtinë (Shtojca 179) si dhe pjesa tjetër e lëndës (Shtojca 180). Në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-463-2/4588/21 dt.06.12.2021 parcela kadastrale 1743-24ka kaluar në emër të [REDACTED] (Shtojca 181) duke u bazuar në kontratën për ndërtim të përbashkët të noterizuar nga noter Sefedin Blakaj me nr. Lrp:8871/2021 Nr.Ref.:2321/2021 dt.10.06.2021 (Shtojca 182) Ankes Kontrata e noterizuar nga noter Sefedin Blakaj me nr.Lrp: 15786/2021 Nr.Ref: 4218/2021 dt.12.10.2021 (Shtojca 183).Në bazë të Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0216686/21 dt.03.11.2021 parcela kadastrale nr.1743-25 Zk. Prishtinë është parcelizuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr.1743-46, 1743-47, Zk Prishtinë, si dhe pjesa tjetër e lëndës(Shiko shtojcat 40,41), Drejtoria e Kadastrit ua dërgon certifikatat e pronësisë (drat Version)lidhur me parcelat kadastrale nr.1743-1, 1743-14, 1743-15, 1743-18,1743-21, 1743-21, 1743-23, 1743-24, 1743-26, 1743-28, 1743-29, 1743-31, 1743-32, 1743-34, 1743-35, 1743-37, 1743-38,1743-40, 1743-42, 1743-43, 1743-44, 1743-47, 1743-49, 1743-50, 1743-51, 1743-52, 1743-53, 1743-54, 1743-55, 1743-56, 1743-57, 1743-58, 1743-59,1743-60, 1743-31, 1743-62, 1743-63, 17430-64, 1743-65,1743-66, 1743-67, 1743-68,1743-69 dhe 10433-0, Zk Prishtinë .

-Fleta poseduese me nr.121/53 i dt 02.01.1953, në bazë të cilës prona 1743 që gjendet në zonën Veternik në Prishtinë është në emër të personit të nacionalitetit serb Stevic Todora Millutin bujk nga Badovci.

-.Kontrata e shitblerjes se pronës lidhur me parcelën me nr.1743 e lidhur me dt.03.01.1953 në mesë të shitësit Stevic Todora Millutin, bujk nga badovci dhe Aziz(Mustaf) Krasniqi nga fshati Zhilivodë, komuna Vuçitërn.

-Kopja e planit për parcelën 1743 e lëshuar nga Drejtoria e Gjedeozisë komunale të prishtinës me nr 1335, e dt. 2janar 1953.

-Aktvendimi i Kuvendit Komunal të Prishtinës-Departamenti për bujqësi, komisioni për paluajtshmërinë e tokës me nr 548/62, me të cilin vendim komisioni në përberje të antarëve Djuro Bauk dhe antaret ink.Radosllav Redenovic dhe Stevam Djurdev, duke vendosur vendosur sipas propozimit të kombinatit- bujqësor-industrial “ KOSMET-EKSPORT”, për bashkimin e tokës, ky komison në bazë të ligjit të atëhershëm në fuqi neni 60 dhe 52 faqë 2 i ligjit themelor për shfrytëzimin e Tokës bujqësore Gazeta Zyrtare FNRJ NR 53/62 dhe nenit të Ligjit për procedurë të përgjithshme, ky komision ka marr aktvendim me të cilin ka vendosur që të pëfshihet dhe ti bashkohet fondit të tokës kombinati industrial KOSMET EKSPORT në Prishtinë, si përdorues dhe e bartë në pronësi publike pronat e tokës nga pronari Aziz Krasniqi, disa ngastra Kadastrale e njëra ndër to edhe nastra kadastrale me nr. 1743 ara e klasës së 5 në vendin e quajtur veternik me sipërfaq prej 2.88.99 ha, ky komison ka mbajtur seancë me dt. 30.09.1963 dhe sipas të njëjti pas shqyrtimit dhe vlerësimit ka

vendosur që pronari i tikës Aziz Krasniqi i ka humbur të drejtat lidhur me këtë tokë pasi që është shpallur armik i shtetit të atëhershëm.

-Aktgjykimi i dt.24.05.1951, i gjykatës popullore e rrethit të Prishtinës, me të cilin Aziz Mustaf Krasniqi është dënuar me burgim të përjetshëm.

-Aktvendimi i marrë nga Dhoma e Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me AKP me nr. AC-I- 16-0104, i përbërë nga kolegji i Apelit në përbërje nga Mr. sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Onderj Pridal, Gertraund Marx- Leitenberger, Ilmi Bajrami, Sabri Halili gjyqtar, duke vendosur sipas ankesës së paditësit Aziz Krasniqi për të njohur të drejtën e pronësisë lidhur me parcelën 1743, që gjente në Veternik Prishtinë, e paraqitur kundër Aktvendimit të kolegjit të specializuar të DHPGJS-së, me nr C-III-12-0040 të datës 12.04.2016, në cilën seancë ka marrur aktvendim me të cilën ankesa e paditësit është e bazuar, me ç'rast kolegji i lartecukur ka anuluar aktvendimin e kolegjit të specializuar dhe Padia kthehet në rigjykim me Kolegjin përkates të specializuar të DHPGJS-së.

Gjykata, pas analizimit të kërkesës për urdhër ndalues përfundimtar dhe të gjitha provave materiale dhe pretendimeve të palëve, gjeti se kërkesa e plotësuar e prokurorisë së shtetit e datës 22.03.2024 është e pa bazuar. Kjo për faktin që pasuria e specifikuar në kërkesë nuk i plotëson kushtet ligjore për t'u lëshuar urdhëri ndalues përfundimtar nga gjykata siç përcaktohet me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, neni 261 paragrafi 1, specifikon kushtet ligjore që duhet të plotësohet për aprovimin e urdhërit ndalues nga gjykata, dhe atë:

Kodi i Procedurës Penale përcakton që urdhëri përfundimtar lëshohet nëse ka dyshim të bazuar se pasuria është pasuri e specifikuar që është përfituar me kryerjen e ndonjë veprë penale dhe se ekziston rreziku që kjo pasuri të tjetërsohet nga dikush tjetër, rrjedhimisht me provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk ka arritur të provojë dyshimin e bazuar se pasuria e paraqitur në kërkesë është pasuri e specifikuar konform nenit 261 të KPP-së.

Gjykata, poashtu ka marr parasysh edhe provat e tjera të sjella nga prokuroria e cila i ka siguruar gjatë zhvillimit të hetimeve kontratën e shitblerjes me nr.1743 e lidhur me datë 03.01.1953 në mes të shitësit Svetiq Todora Miloten, bujk nga Badovci dhe Aziz Mustafë Krasniqi nga komuna e Vushtrrisë, e më pas e njëjta pronë me nr.1743 i'u ka marr nga posedimi me aktvendimin me nr.54862 me të cilin vendim atëherë ka marr aktvendim me të cilën ka vendosur që të përfshihet dhe t'i bashkohet kombinatit Kosmet Eksport Prishtinë si përdorues dhe e bart në pronësi publike nga pronari Aziz Krasniqi dhe atë nga disa ngastra kadastrale e njëra nga to ngastra kadastrale 1743 arë e klasës 5 në vendin e quajtur Veternik, ku ky komisioni ka mbajtur seanc në vitin 1963 dhe sipas të njëjtit pas shqyrtimit dhe vlerësimit ka vendosur që Aziz Krasniqi ka humbur të drejtat për këtë tokë pasi është shpallur armik i popullit.

Gjykata nuk i'a fali besimin kësaj prove pasi që në këtë çështje të procedurës paraprake është relevante të vërtetohet dyshimi i bazuar nga prokuroria e shtetit se parcela si në dispozitiv të kërkesës së përmirësuar të datës 22.03.2024 është pasuri e specifikuar, dhe



fitimi i pronësisë nga i dyshuari Ylber Hyseni është bërë nga kryerja e veprave penale: Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 393 par.4 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me par.1 dhe par.77 të KPRK-së, e jo vërtetim i pronësisë.

Gjykata, poashtu me asnjë provë nuk e vërtetoi dyshimin e bazuar se palët e treta e kanë ditur apo kanë mundur të dijnë për këtë pasuri se është pasuri e specifikuar.

Mirëpo, për gjykatën këto prova nuk janë relevante për të vërtetuar dyshimin e bazuar se i dyshuari këtu Ylber Hyseni ka kryer veprën penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 391 par.1 dhe veprës penale: Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, e kjo rrjedh nga provat që ka pasur gjykata në dispozicion për lëshimin apo jo të urdhërit përfundimtar, duke i marr parasysh aktgjykimet dhe aktvendimet e plotfuqishme të gjykatave dhe mbi këtë bazë në këtë fazë të procedurës paraprake e refuzon kërkesën si në dispozitivin I të kërkesës për urdhër përfundimtar për shkak se me provat e paraqitura nga prokuroria nuk vërtetohet dyshimi i bazuar se i dyshuari Ylber Hyseni ka kryer Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 391 par.1 dhe veprës penale: Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Lidhur me ekspertizat të cilat janë nxjerr nga ana e palëve të dëmtuara, sipas të të cilave dokumenti “Resenje” i datës 15 qershor 1961, është i falsifikuar dhe si i tillë nuk ka qenë bazë për fitimin e pronësisë nga ana e të dyshuarit Ylber Hyseni dhe për të njohur tutje të drejtën e pronësisë, gjykata kostaton se këtyre ekspertizave nuk mund t’ua fal besimin për faktin se të njëjtat i janë dorëzuar prokurorisë nga vet palët e dëmtuara të nxjerra në mënyrë private dhe duke qenë se në këtë fazë të procedurës, bazuar në dispozitat e KPP-së, prokuroria e shtetit është e autorizuar që të nxjerr ekspertiza, po e njëjta ka qëndruar pasive, ashtu që ekspertizat e nxjerra nga palët e dëmtuara i’ka dorëzuar gjykatës, përmes tyre pretendon të vërteton se ekziston dyshimi i bazuar se i dyshuari Ylber Hyseni ka kryer veprat penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 391 par.1 dhe veprës penale: Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Sa i përket pretendimin të prokurorisë së shtetit se dokumentin “Resenje” me të cilën Zojë Hyseni-t, i është marrë e drejta e pronësisë, dhe se të njëjtin nuk e ka pasur asnjëherë në posedim me arsyetimin se historiat për këtë pronë gjendet në Serbi. Gjykata konstaton se një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm dhe i paarsyeshëm për të vërtetuar dyshimin e bazuar se i dyshuari ka kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 391 par.1 dhe veprës penale: Mashtrimi nga neni 323 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Sa i përket kushtit tjetër për t’u lëshuar urdhëri përfundimtar në ngastrat kadastrale që janë në pronësi të personave të tretë, prokuroria me asnjë provë nuk e ka vërtetuar pretendimin se personat e tretë e kanë ditur apo kanë mundur të dijnë se kjo pasuri është pasuri e specifikuar, ndërkaq në seancën dëgjimore të datës 29.04.2024 ku prezentuan edhe palët që kanë interes juridik në këtë çështje penale paraprake, të cilët deklaruan që nuk kanë qenë të

informuar për ndonjë problem lidhur me atë parcelë dhe se atë e kanë vlerë në mënyrë ligjore, ndërsa prokuroria nuk e ka vëretuar të kundërtën se këto palë me interes juridik kanë qenë në dijeni për kërkesën e prokurorisë për urdhër përfundimtar.

Andaj, nga të lartcekurat, gjykata konsideron që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ndalimin/sekuestrimin e Parcelës kadastrale nr.1743-0 Zona Kadastrale, Prishtinë, me sipërfaqe 2.88.29 ha, me ndryshimet e përcaktuara si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ngase për t'u sekuestruar një send, pasuri, duhet që këto sende ose pasuri të përshkruhen se si mund të jenë prova të veprës penale, duhet të ekzistojë dyshimi i bazuar se e njëjta është përfutur me vepër penale, është mjet i kryerjes së veprës penale, dhe të dyshohet se është dobi pasurore e fituar me anë të kryerjes së veprës penale, që mund të shërbejë si provë për kryerjen e veprës penale.

Ndërsa, sa i përket kundërshtimit të avokates Saranda Keqekolla-Sadiku e cila me kundërshtimin e datës 08.05.2024, me të cilën ka sjellë kopjen e autorizimit të noterizuar që av. Venhar Hana e ka përfaqësuar të dyshuarin në procedura tjera gjyqësore në vitin 2020, lidhur me këtë, gjykata konstaton se në shkresat e lëndës, nuk ekziston autorizim me të cilin avHana e ka përfaqësuar të dyshuarin Ylber Hyseni.

Gjykata, pas analizimit të të gjitha provave, nga arsyet e lartpërmendura, në mungesë të kushteve ligjore, refuzon kërkesën e plotësuar të prokurorisë për lëshimin e urdhërit ndalues përfundimtar, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, **si të pabazuar**.

Bazuar në dispozitat e nenit 264 par.2 dhe nenit 268 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij atvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**-Departamenti i përgjithshëm-Penal-**  
**PN.251/22, të datës 15.05.2024**

Gjyqtarja e procedurës paraprake,  
 Edita Çanta



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi, palet kanë të drejtë ankese, përmes kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimit të kësaj gjykate.